



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Ligji Nr. 05/L -012

**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES PËR FINANCIM NDËRMJET
REPUBLIKËS SË KOSOVËS DHE ASOCIACIONIT
NDËRKOMBËTAR PËR ZHVILLIM LIDHUR ME PROJEKTIN PËR
REFORMËN SHËNDETËSORE**

Kuvendi i Republikës së Kosovës;

Në mbështetje të nenit 18 dhe 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miratton

**LIGJ PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES PËR FINANCIM
NDËRMJET REPUBLIKËS SË KOSOVËS DHE ASOCIACIONIT
NDËRKOMBËTAR PËR ZHVILLIM LIDHUR ME PROJEKTIN PËR
REFORMËN SHËNDETËSORE**

Neni 1
Qëllimi i ligjit

Ky ligj ka për qëllim të ratifikojë Marrëveshjen për Financim e lidhur ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim, për financimin e Projektit për Reformën Shëndetësore në Republikën e Kosovës.

Neni 2
Ratifikimi i Marrëveshjes

Ratifikohet Marrëveshja e Financimit ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim për Projektin e Shëndetësisë, e lidhur më 15 Janar 2015, në Prishtinë.

Neni 3
Dokumentet e Bashkëngjitura

Bashkëngjitur me këtë ligj është Marrëveshja e Financimit ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim për Projektin e Shëndetësisë dhe Kushtet e Përgjithshme për Grante dhe Kredi të Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim.

Neni 4
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ligji Nr. 05/L -012
26 mars 2015

Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Kadri VESELI